| **Neni 17**<br>**Refuzimi i Licencës** | **Article 17**<br>**Refusal of License** | **Član 17**<br>**Odbijanje licence** |
| 1. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim në AKK me vendim mund të refuzoj kërkesën e parashtruar nga subjekti për marrjen e licencës për këto arsye; | 1. Commission for reviewing the application for licensing in KCA by decision can refuse the application filed by the entity for obtaining a license for these reasons; | 1. Komisija za razmatranje zahteva za licenciranje u KKA, odlukom, može odbiti zahtev podnesen od strane subjekta za dobijanje licence, iz sledećih razloga; |
| 1.1. ofrimi i të dhënave jo të plota dhe jo të sakta nga ana e parashtruesit të kërkesës; | 1.1. submission of incomplete and inaccurate data by the applicant; | 1.1. pružanje nepotpunih i netačnih podataka od strane podnosioca zahteva; |
| 1.2. në afatin e caktuar nuk kompletohet dokumentacioni; | 1.2. the documentation is not completed in the specified deadline; | 1.2. u određenom roku se ne kompletira dokumentacija; |
| 1.3. në afatin e caktuar nuk i plotëson kushtet për kërkesën e licencimit. | 1.3. in the given term, it does not meet the requirements for the licensing request. | 1.3. u određenom roku se ne ispunjavaju uslovi za zahtev licenciranja. |
| 2. Me rastin e refuzimit të kërkesës, komisioni duhet të merr vendim me arsyet e refuzimit. | 2. In the cases of a refusal of the request, the commission shall take a decision on the justification for refusal. | 2. Prilikom odbijanja zahteva komisija donosi odluku, sa razlozima o odbijanju. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Kundër vendimit të komisionit për licencim, pala e pakënaqur mund të hap konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i vendimit. | 3. Against the decision of the licensing committee, the unsatisfied party may file an administrative dispute with the Basic Court in Prishtina within thirty (30) days of receipt of decision. | 3. Protiv odluke komisije za licenciranje, nezadovoljna stranka može pokrenuti administrativni spor pri Osnovnom Sudu u Prištini, unutar roka od trideset (30) dana od dana primitka odluke. |
| **Neni 18**<br>**Kartela identifikuese** | **Article 18**<br>**Identification card** | **Član 18**<br>**Identifikaciona kartica** |
| 1. Kompanitë gjeodete të licencuara, gjeodetët e licencuar dhe teknikët gjeodetë të licencuar nga komisioni i AKK-së pajisen me kartelë identifikuese. | 1. Licensed geodesy companies and licensed geodesist by the KCA commission are equipped with an identification card. | 1.Licencirane geodetske kompanije i licencirani geodeti od strane Komisije KKA-a dobijaju identifikacionu karticu. |
| 2. Kompanitë gjeodete të licencuara, gjeodetët e licencuar dhe teknikët gjeodetë të licencuar janë të obliguar që kartelën identifikuese ta përdorin në këto raste: | 2. Licensed surveying companies, licensed surveyors, licensed separatë phyical persons and licensed tchnichan surveyor are obliged to use the identification card in the following cases: | 2.Licencirana geodetska kompanija, licencirani geodeta, licencirano posebno fizičko lice i licensirani tehničar geodeta, dužni su da identifikacionu karticu upotrebljava u sledećim slučajevima: |
| 2.1. prezantimi para pronarëve, shfrytëzuesve të pronave të paluajtshme dhe personave të tretë që kanë interes juridik për pronën e caktuar; | 2.1. presentation to owners, beneficiaries of immovable property and other persons, who have a legal interest in the assigned property; | 2.1. predstavljanje pred vlasnicima, korisnicima nepokretnih imovina i trećim licima, koji imaju pravni interes za određenu imovinu; |
| 2.2. para pronarëve dhe personave që kanë interes në momentin e hyrjes në pronat e tyre për kryerjen e punëve profesionale në terren; | 2.2. to the owners and interested persons on entry to their properties to perform professional work in the field; | 2.2. pred vlasnicima i licima koji imaju interes u trenutku ulaska u njihovim imovinama za obavljanje stručnih poslova na terenu; |
| 2.3. prezantimin para organeve kompetente që janë të autorizuara të bëjnë mbikëqyrjen | 2.3. presentation to competent bodies, which are authorized to supervise the work | 2.3. predstavljanje pred nadležnim organima koji su ovlašćeni da nadgledaju |

| | | |
|---|---|---|
| e punës së kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve të licencuar. | of licensed surveyors and geodetic companies. | rad geodetskih kompanija i licenciranih geodeta. |
| 3. Forma, madhësia dhe përmbajtja e kartelës identifikuese përcaktohet me vendim të veçantë nga AKK-ja. | 3. The form, size and content of the identification card is determined by a special decision by the KCA. | 3. Oblik, veličina i sadržaj identifikacione kartice određuje se posebnom odlukom od strane KKA-a. |
| **Neni 19**<br>**Ndryshimet e kushteve nga personi fizik dhe juridik i licencuar** | **Article 19**<br>**Changes of condition of a licensed natural or legal person** | **Član 19**<br>**Razlike uslova između licenciranog fizičkog ili pravnog lica** |
| 1. Për të gjitha ndryshimet që ndodhin në personin fizik apo juridik të licencuar, sipas këtij Udhëzimi Administrativ, duhet të njoftohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim në afatin prej tetë (8) ditësh nga dita e paraqitjes së ndryshimeve. | 1. All changes that occur to a natural or legal person licensed under this Administrative Instruction shall be notified to the committee on the examination of licensing requirements within eight (8) days of the date of submission of the changes.. | 1. Za sve promene koje nastaju kod licenciranog fizičkog ili pravnog lica, prema ovom Administrativnom Uputstvu, treba se obavestiti komisija za razmatranje zahteva za licenciranje, u roku od osam (8) dana, od dana nastajanja promena. |
| 2. Për ndryshimet për të cilat AKK-ja është informuar dhe të cilat kanë ndikim në kushtet e licencimit, atëherë komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim merrë vendim për këto ndryshime. | 2. For changes for which the KCA has been informed, and which have an impact on licensing conditions, the Commission for reviewing the application for licensing shall take a decision on these changes. | 2. Za izmene o kojima je KAA obaveštena, i koje imaju uticaj u uslovima licenciranja, onda Komisija za razmatranje zahteva za licenciranje donosi odluku o tim izmenama. |
| 3. Kundër këtij vendimi mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i vendimit. | 3. An administrative dispute may be opened against this decision at the Basic Court in Prishtina within thirty (30) days of its receipt. | 3. Protiv ove odluke može se otvoriti administrativni spor, pri Osnovnom Sudu u Prištini, unutar roka od trideset (30) dana, od primitka iste. |

| Neni 20<br>Obligimet e personit fizik dhe juridik të licencuar | Article 20<br>Obligations of licensed physical or legal person | Član 20<br>Obaveze licensiranog fizičkog ili pravnog lica |
|---|---|---|
| 1. Personi fizik apo juridik i licencuar sipas këtij Udhëzimi Administrativ është i obliguar që: | 1. The natural or legal person licensed under this Administrative Instruction is obliged to: | 1. Licencirano fizičko ili pravno lice prema ovim Administrativnim Uputstvom, dužno je da: |
| 1.1. punët profesionale të kryhen në bazë të të dhënave zyrtare, të cilat merren nga ZKK-ja; | 1.1. to perform professional duties based on official data, given by the KCA; | 1.1. stručne poslove obavljaju na osnovu zvaničnih podataka, koja se dobijaju od strane OKK-a; |
| 1.2. punët profesionale të kryhen në pajtim me dispozitat legjislacionit në fuqi si dhe sipas standardeve dhe etikës profesionale; | 1.2. perform professional works in accordance with the provisions of laws in force, according to professional standards and ethics; | 1.2. stručni poslovi se trebaju obaviti u skladu sa zakonom i drugim normativnim odredbama, prema standardima i stručnoj etici; |
| 1.3. punët, shërbimet dhe llogaritja e çmimeve për shërbimet e kryera, bëhet sipas tarifave të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi e cila duhet të dëshmohet me faturë të rregullt ose kupon fiskal; | 1.3. works, services and price calculation for performed services are made only under the tariffs set by aplicible legislation Instruction, which must be evidenced by a regular invoice or a fiscal coupon; | 1.3. poslovi, usluge i obračunanje cena za obavljane usluge, samo prema tarifama određenim primenjlivim zakonodavstom, koja se treba dokazati uobičajenom fakturom ili fiskalnim računom; |
| 1.4. në mënyrë të barabartë dhe të drejtë të vendos për kërkesat e palëve për kryerjen e punëve profesionale, pavarësisht nga ndërlikimi, vendi dhe koha e kryerjes së punëve; | 1.4. equally and fairly decide on the claims of the parties by performing the professional work, regardless of the complexity, the place and time of the works; | 1.4. jednako i pravično se treba odlučiti o zahtevima strana za obavljanje stručnih poslova, bez obzira na složenost, mesto i vreme obavljana poslova; |
| 1.5. nuk ka të drejtë, pa arsye, të refuzoj kryerjen e punëve profesionale sipas kërkesave të palëve; | 1.5. has no right, without justification, to refuse to perform professional duties according to the requirements of the parties; | 1.5. nema pravo da, bez razloga, odbije obavljanje stručnih poslova prema zahtevima stranaka; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.6. në lokalin e punës të vendosë orarin e rregullt të punës dhe listën e tarifave; | 1.6. at the workplace to set the regular working schedule and the tariff list; | 1.6. u lokalu za rad treba da postavi redovno radno vreme i listu tarifa; |
| 1.7. të lajmëroj ZKK-në dhe AKK-në për pengesat e arsyeshme në kryerjen e punëve profesionale, të cilat zgjasin mbi një muaj. | 1.7. to notify the MCO and the KCA of the reasonable obstacles in carrying out professional work, which last for more than a month; | 1.7. da obavesti OKK i KKA o razumnim preprekama u obavljanju stručnih poslova, koje traju preko mesec dana; |
| 1.8. pengesa të arsyeshme konsiderohen: mungesa e arsyeshme nga puna sipas ligjit; kushtet e vështira atmosferike; kushtet e rënda për punë në terren dhe raste të tjera që e bëjnë të pamundur kryerjen e punëve profesionale; | 1.8. reasonable obstacles are considered to be: reasonable absence from work under the law, difficult atmospheric conditions and severe conditions for fieldwork and other cases that make impossible to carry out professional work. Evaluation of reasonable obstacles is done by KCA; | 1.8. razumne prepreke smatraju se: opravdan izostanak sa posla, prema zakonu, teški atmosferski uslovi i teški uslovi za rad na terenu i drugi slučajevi, koji onemogućavaju obavljanje stručnih poslova. Procenu razumnih prepreka čini KKA; |
| 1.9. lajmërimi duhet të bëhet në afatin prej tre (3) ditësh nga dita e paraqitjes së pengesave. Vlerësimin e pengesave të arsyeshme e bën AKK-ja; | 1.9. the notification must be made within three (3) days from the date of the occurrence of the obstacles. The assessment of reasonable impediments is made by the KCA; | 1.9. obaveštenje se mora izvršiti u roku od tri (3) dana od dana nastanka prepreka. KKA vrši procenu razumnih prepreka; |
| 1.10. në bazë të urdhrit të ZKK-së, ose të AKK-së, të përsërit kryerjen e punëve profesionale me shpenzimet e veta dhe me pëlqimin e palës nëse është vlerësuar që punët nuk i plotësojnë kriteret; | 1.10. based on the order of the MCO, or the KCA, to repeat the performance of professional work at its own expense and with the consent of the party if it is assessed that the work does not meet the criteria; | 1.10. po nalogu OKK-a ili KKA da ponovi obavljanje profesionalnog rada u svom trošku i uz saglasnost stranke ako se proceni da rad ne ispunjava kriterijume; |
| 1.11. për çdo vit të bëjë raport vjetor të punës dhe të njëjtin t'a dorëzoj në AKK. | 1.11. every year to make annual work report and submitt the same report in KCA. | 1.11. za svaku godini treba se sačiniti godišnji izveštaj rada, a isti dostaviti KKA. |

| Neni 21<br>Ofrimi i të dhënave dhe shënimeve kadastrale | Article 21<br>Provision of cadastral data and records | Član 21<br>Pružanje katastarskih podataka i beleški |
|---|---|---|
| 1. ZKK-ja është e obliguar që me kërkesën e personit fizik apo juridik të licencuar, sipas këtij Udhëzimi Administrativ, t'i ofroj të dhëna dhe shënime të cilat i posedon, pas pagesës së kryer sipas tarifave të përcaktuara. | 1. The MCO is obliged, at the request of a natural or legal person licensed under this Administrative Instruction, to provide data and records that they possess after payment has been made at the prescribed rates. | 1. OKK je dužna da na zahtev licenciranog fizičkog ili pravnog lica prema ovim Administrativnim Uputstvom, da pruži podatke i beleške koje poseduje, nakon obavljene uplate, prema zakonom određenim tarifama. |
| 2. Afati për dhënien e shënimeve është një (1) ditë pune nga dita e parashtrimit të kërkesës me shkrim. | 2. The deadline for issuing the notes is one (1) working day from the day of receipt of the written request. | 2. Rok za pružanje podataka je jedan (1) radni dan od dana podnošenja pisanog zahteva. |
| 3. Kur ZKK-ja nuk i ofron të dhënat sipas afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, personi fizik apo juridik i licencuar sipas këtij Udhëzimi Administrativ, mund të parashtrojnë ankesë në AKK, e cila duhet t'a kthej përgjigjen për këtë çështje brenda afatit prej tre (3) ditë pune. | 3. Where the MCO does not provide the data within the time limit set in paragraph 2 of this Article, a natural or legal person licensed under this Administrative Instruction may file a complaint at the KCA, which shall return a response to this issue within three (3) business days. | 3. Kada OKK ne pruža podatke prema osređenim rokom u stavu 2 ovog člana, licencirano fizičko ili pravno lice prema ovim Administrativnim Uputstvom može podneti KKA-u, koja je onda dužna da vrati odgovor po ovom pitanju unutar roka od tri (3) radna dana. |
| 4. ZKK-ja është e obliguar që në tabelën e vet të shpalljeve të publikoj listën e personave fizik apo juridik të licencuar sipas këtij Udhëzimi Administrativ për kryerjen e punëve profesionale të gjeodezisë dhe të kadastrës. | 4. The MCO is obliged to publish in its bulletin board the list of natural or legal persons licensed under this Administrative Instruction for performing professional geodetic and cadastral works. | 4. OKK je dužna da na svojoj tabeli oglasa oglasi listu licenciranih fizičkih ili pravnih lica prema ovom Administrativnom Uputstvu za obavljanje stručnih poslova geodezije i katastra. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 22**<br>**Arsyet për pushimin e punës së kompanisë gjeodete**<br><br>1. Kompania gjeodete pushon veprimtarinë e saj, kur:<br><br>1.1. shuhet kompania gjeodete;<br><br>1.2. hapet procedura e falimentimit apo likuidimit;<br><br>1.3. me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës i është shqiptuar ndalesa e ushtrimit të veprimtarisë;<br><br>1.4. për shkaqe të paarsyeshme nuk e fillon ushtrimin e veprimitarisë në afat prej katerdhjet e pesë (45) ditësh nga dita e dhënies së licencës;<br><br>1.5. pushojnë së plotësuari kushtet, në bazë të të cilave kanë fituar licencimin.<br><br>**Neni 23**<br>**Arsyet për pushimin e punës të personit fizik të licencuar**<br><br>1. Personi fizik i licencuar sipas këtij Udhëzimi Administrativ pushon veprimtarinë: | **Article 22**<br>**Reasons for termination of the work of geodetic company**<br><br>1. The geodetic company ceases its activity when:<br><br>1.1.when the geodetic company quits (ceases to exist as a company);<br><br>1.2.the bankruptcy or liquidation procedure is open;<br><br>1.3. by a final judgment of the court, the company / owner has been convicted with prohibition on exercising the activity has been imposed;<br><br>1.4. for unjustified reasons does not commence the exercise of the action within fortyfive (45) days from the day of issuing the license;<br><br>1.5.ceases to meet the conditions under which they have been licensed.<br><br>**Neni 23**<br>**Reasons for dismissal of a licensed natural person l**<br><br>1. A natural person licensed under this Administrative Instruction shall cease to operate: | **Član 22**<br>**Razlozi za prestanak rada geodetske kompanije**<br><br>1. Geodetska kompanija prestaje sa svojom delatnošću kada:<br><br>1.1. se gazi geodetska kompanija;<br><br>1.2. pokrene stečajni postupak ili postupak likvidacije;<br><br>1.3. pravosnažnim rešenjem suda je izrečena mera prestanka delatnosti;<br><br>1.4. iz neopravdanog razloga ne počinje sa obavljanje delatnosti u roku od četerdeset i pet (45) dana od dana izdavanja licence;<br><br>1.5. prestaje da ispunjava uslove, na osnovu kojih je dobio licenciranje.<br><br>**Neni 23.**<br>**Razlozi za prestanak rada licenciranog fizičkog lica**<br><br>1. Licencirano fizičko lica prema ovim Administrativnim Uputstvom prekida aktivnost: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. në rast të vdekjes; | 1.1. in case of death; | 1.1. u slučaju smrti; |
| 1.2. me dorëheqje me shkrim; | 1.2. by resignation in writing; | 1.2. pismenom ostavkom; |
| 1.3. kur me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është dënuar për veprën penale përvetësim në detyrë apo është dënuar me dënim me burg pakusht mbi gjashtë (6) muaj, ose nëse i është shqiptuar ndalesa e ushtrimit të veprimtarisë; | 1.3. when by a final judgment of the court he or she has been convicted of the criminal offense of embezzlement or sentenced to imprisonment for more than six (6) months, or if a prohibition on exercising his activity has been imposed; | 1.3. kada je pravosnažnim rešenjem suda je kažnjena za krivično delo pronevere na dužnosti ili je kažnjen na uslovnu kaznu zatvora preko šest (6) meseci, ili ukoliko je izrečena mera prestanka delatnosti ; |
| 1.4. kur për shkaqe të paarsyeshme nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë në afat prej katërdhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e dhënies së licencës; | 1.4. when for unjustified reasons does not commence the exercise of the activity within fourtyfive (45) days from the day of issuance of the license; | 1.4. kada iz neopravdanog razloga ne počinje sa obavljanje delatnosti u roku od ceterdeset i pet (45) dana od dana izdavanja licence; |
| 1.5. kur personi fizik i licencuar sipas këtij Udhëzimi Administrativ ka vendqëndrim me tepër se një (1) muaj jashtë Republikës së Kosovës, pa njoftim të AKK-së; | 1.5. when a natural person licensed under this Administrative Instruction has been resident for more than one (1) month outside the Republic of Kosovo, without notice to the KCA; | 1.5. kada licencirano fizičko lice prema ovim Administrativnim Uputstvom ima prebivalište vise od jednog (1) meseca izvan Republike Kosova, bez obaveštenja KKA-u; |
| 1.6. pushojnë së plotësuari kushtet, në bazë të të cilave kanë fituar licencimin. | 1.6. cease to meet the conditions under which they have obtained the license. | 1.6. prestaju da ispunjavaju uslove pod kojima su stekli licencu. |
| **Neni 24**<br>**Pezullimi i licencës** | **Article 24**<br>**Suspension of License** | **Član 24**<br>**Obustava licence** |
| 1. Me kërkesë të personit fizik të licencuar, komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim mund të pezulloj licencën në afat prej gjashtë (6) muaj. | 1. At the request of the licensed natural person, the kommission for reviewing the application for licensing may suspend the license within six (6)months. | 1.Sa zahtevom licenciranog fizičkog lica, komisija za razmatranje zahteva za licenciranje a može da obustavi licencu u roku od šest (6)meseci. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Me kërkesë të personit fizik të licencuar, komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim mund të pezulloj licencën në afat prej një (1) viti me qëllim të shfrytëzimit të pushimit të lehonisë.<br><br>3. Me njoftimin e palës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ndërmjet kompanisë dhe personit fizik me të cilin është licencuar ajo.<br><br>4. Pezullimi nga paragrafi 3. i këtij neni, bëhet deri në tre (3) muaj.<br><br>5. Licenca pushon kur brenda afatit nga paragrafi 4 i këtij neni nuk plotësohet kushti nga neni 8 paragrafi 1.2 i këtij Udhëzimi Administrativ.<br><br>6. Në rastet kur personi fizik i licencuar lidhë marrëdhënie pune me kompani gjeodete, komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim pezullon licencën në kohën deri sa zgjat kjo marrëdhënie pune.<br><br>**Neni 25**<br>**Revokimi i licencës për punë**<br><br>1. Personit fizik dhe juridik të licencuar i merret licenca në rastet, kur: | 2. At the request of the licensed natural person, the Commission for reviewing the application for licensing may suspend the license within one (1) year for the purpose of using maternity leave.<br><br>3. With the notice of the party terminating the working relationship between the company and the natural person with whom it was licensed.<br><br>4. The suspension from paragraph 3 of this article is made up to three (3) months.<br><br>5. The license ceases when within the time limit from the paragraph 4 of this annex, is not fulfilled the condition referred to in article 8 paragraph 1.2 of this Administrative Instruction.<br><br>6. In cases when a licensed natural person concludes employment with a surveying company, the licensing claims review commission shall suspend the license for the duration of such employment.<br><br>**Article 25**<br>**Revocation of license**<br><br>1.Licensed natural and legal person shall be revoked the license in cases when: | 2. Na zahtev licenciranog geodete, Komisija za razmatranje zahteva za licenciranje može da obustavi licencu u roku od jedne (1) godine, sa ciljem korišćenja porodiljskog odsustva.<br><br>3. Sa obaveštenjem stranke za prekid radnog odnosa između kompanijei fizičkog lica, kojim je isti licenciran.<br><br>4. Obustava iz stava 3 ovog člana se vrši do tri (3) meseca.<br><br>5. Licenca prestaje da vazi kada unutar roka iz stava 4 ovog člana ne ispunjava se uslov iz člana 8. Stav 1.2 ovog Administrativnog Uputstva.<br><br>6. U slučajevima kada licencirano fizičko lice stvara radni odnos sa geodetskom kompanijom, komisija za razmatranje zahteva za licenciranje obustavlja licencu za vremtrajanje radni odnos.<br><br>**Član 25**<br>**Opozivanje licence za rad**<br><br>1.Licenciranom fizičkom i pravnom licu se oduzima licenca, u slučajevima kada: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. nuk i kryejnë punët dhe shërbimet kadastrale në pajtim me Ligjin nr. 04/L-013 për Kadastër;<br><br>1.2. punët, shërbimet dhe llogaritjen e çmimeve për shërbimet e kryera i bëjnë në kundërshtim me tarifat e përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi;<br><br>1.3. pa arsye mungojnë me tepër se tridhjetë (30) ditë në ushtrimin e profesionit. | 1.1.do not perform works and cadastral services in accordance with Law no. 04/L-013 on Cadaster;<br><br>1.2. works, services and price calculations for the services performed are in contravention with the tariffs set forth in the applicable legal provisions;<br><br>1.3. without reason, they are absent more than thyrten (30) days to exercise a profesion. | 1.1. ne obavljaju i katastarske poslove i usluge u skladu sa Zakonom br. 04/L-013 o Katastru;<br><br>1.2 . poslove, usluge i računanje cena za obavljane usluge vrše u suprotnosti sa tarife navedene u važećim zakonskim odredbama;<br><br>1.3. neopravdano izostaju više od trideset (30) dana u obavljanju struke. |
| 2. Revokimi i licencës mund të bëhet pasi t'iu tërhiqet vërejtja më parë nga komisioni për licencim për të metat në punë dhe shkeljen e dispozitave ligjore dhe të udhëzimeve administrative në fuqi. | 2. Revocation of a license can be made after a prior warning, for failures at work and violation of legal provisions and administrative instructions by the licensing commission are withdrawn. | 2. Opozivanje licence se može vršiti nakon prve opomene za nedostatke na poslu i kršenje zakonskih odredbi i administrativnih uputstava od strane komisije za licenciranje. |
| 3. Personit fizik dhe juridik të licencuar me vendim të komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim i revokohet licenca. | 3. The licensed natural and legal person shall be revoked his / her license by the decision of the commission for the examination of licensing applications. | 3. Licenciranom fizičkom i pravnom licu, odlukom komisije za razmatranje zahteva za licenciranje, oduzima se licenca. |
| 4. Personat fizik dhe juridik të licencuar nuk kan të drejtë të kërkonjë licencimin për punë para se të kaloj afati prej dy (2) viteve nga dita e revokimit të licencës, sipas paragrafit 3 të këtij neni. | 4. Licensed natural and legal persons has no right to request work licensing again before the expiration of two (2) years from the date of revocation of the license under paragraph 3 of this article. | 4. Licencirana fizička i pravna lica nemaju pravo da zahtevaju licenciranje za rad pre prelaska roka od dve (2) godine od dana opozivanja licence, prema stavu 3. ovog člana. |
| 5. Kundër vendimit të komisionit të AKK-së për revokimin e licencës mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën Themelore | 5. Against the decision of the KCA commission to revoke a license, an administrative dispute may be opened at the | 5. Protiv odluke Komisije KKA-a, za opozivanje licence, može se pokrenuti administrativni spor pri Osnovnom Sudu u |

| | | |
|---|---|---|
| në Prishtinë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i vendimit.<br><br>**Neni 26**<br>**Testi për licencim**<br><br>1. AKK-ja organizon testin për licencim.<br><br>2. Mënyra e organizimit të testit për licencim rregullohet me udhëzues të nxjerrë nga AKK-ja.<br><br>**Neni 27**<br>**Mbikqyrja e punëve kadastrale nga ZKK**<br><br>1. Punët kadastrale të parapara në këtë Udhëzim Administrativ kryhen nga personat fizik dhe juridik të licencuar ndërsa kontrollimi, aprovimi dhe regjistrimi i të dhënave kadastrale bëhet nga ZKK-ja.<br><br>2. ZKK kryen punë kadastrale të terrenit vetëm për interes publik me kërkesë të komunës.<br><br>**Neni 28**<br>**Dispozitat ndëshkimore**<br><br>1.Personi fizik dhe juridik i licencuar sanksionohet sipas nenit 33 të Ligjit nr. 04/L-013 për Kadaster në rastet kur: | Basic Court in Pristina within thirty (30) days of its receipt.<br><br>**Article 26**<br>**The exam for licencing**<br><br>1. KCA organizes the exam for licencing.<br><br>2. The way of organization of exam for licencing with instructions issued by KCA.<br><br>**Article 27**<br>**Supervision of cadastral works by the MCO**<br><br>1. Cadastral affairs foreseen in Administrative Instruction, are conducted licensed physical and natural person, while the inspection, approval and recording of cadastral data according is conducted from MCO.<br><br>2. MCO conducts cadastral works only for public interest, with the requirement of municipality.<br><br>**Article 28**<br>**Punitive Provisions**<br><br>1. Licensed natural and legal person is fined according to artical 33 of the Law nr. 04/L-013 Cadaster in cases when: | Prištini, unutar roka od trideset (30) dana, od dana primitka iste.<br><br>**Član 26**<br>**Test za licenciranje**<br><br>1. KKA organizuje test za licenciranje.<br><br>2. Način organizovanja testa za licenciranje uređuje se jednim uputstvom, donetim od KKA-a.<br><br>**Član 27**<br>**Nadzor katastarskih radova od OKK**<br><br>1. Katastarski poslovi propisani ovim Administrativnim Uputstvom, obavljaju se od licensiranih pravnih i fizičkih lica, dok kontrola, odobravanje i registracija katastarskih podataka, vrše se od strane OKK.<br><br>2. OKK obavlja katastarske poslove samo u javnom interesu na zahtev opštine.<br><br>**Član 28**<br>**Kaznene odredbe**<br><br>1. Licencirano fizičko i pravno lice kažnjava se prema clanu 33 Zakona br. 04/L-013, za Kadaster , u slučajevima kada: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1.punët profesionale nuk kryhen në bazë të dhënave zyrtare të gjeodezisë dhe të kadastrës, të cilat merren zyrtarisht nga ZKK-ja dhe AKK-ja; | 1.1. professional works are not carried out on the basis of official geodetic and cadastral data, which are officially taken by the MCO and the KCA; | 1.1. stručni poslovi se ne obavljaju na osnovu zvaničnih geodetskih i katastarskih podataka, koji se dobijaju zvanično od strane OKK-a i KKA-a; |
| 1.2. punët profesionale nuk kryhen në mënyrë cilësore në pajtim me ligjin nr. 04/L-013 për Kadastër dhe sipas standardeve, normave teknike dhe etikës profesionale; | 1.2. professional work is not carried out in a qualitative manner, in accordance with law no. 04 / L-013 on Cadaster and according to standards, technical norms and professional ethics; | 1.2. stručni poslovi ne obavljaju kvalitetno, u skladu sa zakonom br. 04/L-013 o katastru i prema standardima, tehničkim normama i stručnoj etici; |
| 1.3. punët, shërbimet dhe llogaritja e çmimeve për shërbimet e kryera bëhen në kundërshtim me tarifat e përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi; | 1.3. works, services and pricing for the services are made contrary to the fees set forth in the applicable legal provisions; | 1.3. poslovi, usluge i obračunavanje cena za obavljane usluge vrše se u suprotnosti sa tarifama navedene u važećim zakonskim odredbama; |
| 1.4 pa arsye ka refuzuar kryerjen e punëve profesionale sipas kërkesave të palëve; | 1.4 without reason has refused to carry out professional duties as required by the parties; | 1.4. neopravdano je odbio obavljanje stručnih poslova prema zahtevima strana; |
| 1.5. në afatin e caktuar nga organet kompetente mbikëqyrëse nuk i eliminon parregullsitë e konstatuara; | 1.5. within the deadline set by the competent supervisory bodies do not eliminate the identified irregularities; | 1.5. u roku određenom od strane nadležnih organa ne eliminiše utvrđene nepravilnosti; |
| 1.6. nuk e informojnë AKK-në për çdo ndryshim që ka të bëjë me punën dhe mosplotësimin e kushteve të licencimit për kompaninë apo gjeodetin e licencuar; | 1.6. do not inform the KCA of any changes that have to do with the work and the failure to fulfill the licensing conditions for the licensed company or geodesist; | 1.6. ne obaveste KKA o svakoj izmeni koja se odnosi na rad i neispunjavanje uslova licenciranja za kompaniju ili licenciranog geodetu; |
| 1.7. para selisë apo lokalit të punës nuk e vendosin orarin e rregullt të punës të kompanisë apo të gjeodetit të licencuar; | 1.7. in front of the headquarters or working premises do not set the regular working hours; | 1.7. ispred sedišta i lokala za rad ne postave redovno radno vreme kompanije ili licenciranog geodete; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.8. nuk e lajmërojnë ZKK-në për pengesat e arsyeshme në kryerjen e punëve profesionale, të cilat zgjasin më shumë se një (1) muaj; | 1.8. do not notify the MCO of reasonable obstacles in carrying out the professional works, which last more than one (1) month; | 1.8. ne obaveštavaju OKK o razumnim preprekama u obavljanju stručnih poslova, koji traju više od jednog (1) meseca; |
| 1.9. nuk veprojnë në bazë të urdhërit të ZKK-së ose të AKK-së për përsëritjen e kryerjes së punëve profesionale me shpenzimet e veta. | 1.9. do not act on the basis of the order of the MCO or the KCA for repetition and performance of professional work at its own expense. | 1.9. ne deluju na osnovu naloga OKK-a ili KKA-a za ponavljanje stručnih poslova o svom trošku. |
| 2. Sanksionet sipas paragrafit 1 të këtij neni i shqipton Gjykata Kompetente. | 2. The sanctions referred to in paragraphs 1 of this article shall be imposed by the Competent Court. | 2. Sankcije prema stava 1 ovog člana, izriče Nadlezni Sud. |
| **Neni 29**<br>**Dispozita kalimtare dhe përfundimtare** | **Article 29**<br>**Transitional and finalprovisions** | **Član 29**<br>**Prelazne i konačne odredbe** |
| Gjeodetët e licencua, kompanitë gjeodete dhe personat fizik të vaçantë të licencuar të cilët kanë licencë të vlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ në afatin prej një (1) viti duhet t'i plotësojnë kushtet e parapara në dispozitën e nenit 6, 8, dhe 11 të këtij Udhëzimi Administrativ, duke përjashtuar dispozitën e nenit 6 paragrafi 1.6 të këtij Udhëzimi Administrativ. | Licensed surveyors, and licensed surveying companies and special natural persons that have a valid license at the moment of entry into force of this Administrative Instruction within a period of one (1) year must meet the conditions set forth in the provisions of articles 6, 8 and 11 of this Administrative Instruction, excluding the provision of article 6 paragraph 1.6 of this Administrative Instruction. | Licencirani geodeti i licencirane geodetske kompanije i posebna fizička lica koje imaju validnu licencu u trenutku stupanja na snagu ovog Administrativnog Uputstva u roku od jedne (1) godine treba da ispunjavaju predviđane uslove u odredbi člana 6, 8, i 11 ovog Administrativog Uputstva, izuzimajući odredbu člana 6 stav 1.6 ovog Administrativnog Uputstva. |
| **Neni 30**<br>**Shfuqizimi** | **Article 30**<br>**Abrogation** | **Član 30**<br>**Stavljanje van snage** |
| Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.01/2013 për | With the entry into force of this Administrative Instruction shall be abrogated the MESP Administrative Instruction No 01/2013, on the | Stupanjem na snagu ovog Administrativnog Uputstva stavlja se van snage AdministrativnoUputstvo MSPP Br. 01/2013 |

| | | |
|---|---|---|
| Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve. | Licensing of Surveying Companies, and Surveyors. | o Licenciranje Geodetskih Kompanija i Geodeta. |
| **Neni 31**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 31**<br>**Entry into force** | **Član 31**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. | This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after signing by the Minister of the Ministry of Environment and Spatial Planning. | Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od strane Ministra Ministarstva Životne Sredine i Prostornog Planiranja. |
| Fatmir Matoshi<br>Ministr i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | Fatmir Matoshi<br>Minister of Ministry of the Environment and Spatial Planning. | Fatmir Matoshi<br>Ministar Ministarstva Životne Sredine i Prostornog Planiranja |
| Datë:15.11.2019<br>Prishtinë | Date:15.11.2019<br>Prishtina | Dana:15.11.2019. god.<br>Priština |